

08/1

2178

2/8/23, 2:31 PM

Gmail - Pergjigje kerkeses per informacion



Res Publica <qendra.respublica@gmail.com>

## Pergjigje kerkeses per informacion

Alida Beqiraj <Alida.Beqiraj@kpa.al>

Wed, Feb 8, 2023 at 1:41 PM

To: "qendra.respublica@gmail.com" <qendra.respublica@gmail.com>

Te nderuar!

Ne vijim te kerkeses suaj per informacion drejtuar Kolegjit te Apelimit, ju bejme me dije siç vijon:

Pas vënies në dijeni për marrjen në cilësinë e të pandehurit të gjyqtarit Ardian Hajdari nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, më datë 07.02.2022, ka zhvilluar Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila me vendimin nr.13, datë 07.02.2022, në mbështetje të nenit C, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, të nenit 128, pika 3, germa "b", të nenit 179, pika 7, si dhe të nenit 179/b, pikat 5 dhe 6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka vendosur:

Pezullimin nga detyra të gjyqtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, z. Ardian Hajdari. Këtë vendim mund ta gjeni bashkëlidhur e-mail-it.

Sa i përket statusit të çështjes penale të gjyqtarit Ardian Hajdari, ju bëjmë me dije se vijon gjykimi në Gjykatën e Posaçme e Shkallës së Parë për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin, me marrjen dhe shqyrtimin e provave të kërkua.

Ju bëjmë me dije se aktualisht, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit ushtrojnë funksionin 6 gjyqtarë:

- Gjyqtare Albana Stylla
- Gjyqtare Ina Rama
- Gjyqtare Mimoza Tasi
- Gjyqtare Natasha Mulaj
- Gjyqtar Rezarta Schuetz
- Gjyqtar Sokol Çomo

Faleminderit!



**Alida Beqiraj**  
 Koordinatore për Mediat dhe Marrëdhëniet me Jashtë  
 Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Mediat dhe Publikun  
 Kolegji i Posaçëm i Apelimit  
 Mobile : +355692054104  
 Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë  
 www.kpa.al



Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privileguara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar, është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Ne nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga viruse, përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT  
MBLEDHJA E GJYQTARËVE

Nr. 224 prot.

Tiranë, më 07.02.2022

**VENDIM**

**“I Mbledhjes së Gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelitit”**

**Nr. 13 , datë 07.02.2022**

Në mbështetje të nenit C, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës; nenit 128, pika 3, germa “b”, nenit 179, pika 7, si dhe nenit 179/b, pikat 5 dhe 6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Mbledhja e Gjyqtarëve

**VENDOSI:**

1. Pezullimin nga detyra të gjyqtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelitit, z. Ardian Hajdari.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**

